



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
DREJTORIA EKONOMIKE

Nr. 5707 Prot.

Dt. 22.09.2023

PROJEKT - VENDIM

NR 86 .DATE 22 .09 .2023

“PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË PBA 2024-2026 TE RISHIKUAR”

Në mbështetje të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, të ligjit nr. 9936 datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, të ligjit nr.68 datë 27.04.2017 “Për financat e qeverisjes vendore”, të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të Programimit Buxhetor Afatmesëm” të ndryshuar me udhëzimin nr.7 datë 25.02.2022 “Per nje ndryshim në Udhëzimin nr.23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të Programimit Buxhetor Afatmesëm”; të Udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 6, datë 28.02.2023 “Per përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026”, si dhe materjaleve të sjella nga Drejtoria e Ekonomike;

- Ju paraqesim për diskutim e miratim,

1. Të miratojë dokumentin për Programin Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 të rishikuar për Bashkinë Roskovec dhe 2 njësitë shpenzuese në vartësi, sipas tabelave në formatet output dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë bashkelidhur:
 - Tabelen 1 “Tavanet e Programeve Buxhetore”;
 - Tabelen 2 “Burimet Buxhetore”;
 - Tabelen 3-5 “Shpenzimet sipas kategorive ekonomike”;
 - Tabelen 4 “Shpenzimet sipas klasifikimit funksional”;
 - Tabelen 4.1 “Shpenzimet sipas programeve”;
 - Tabelen 6 “Deklarata e politikës së programeve”;
 - Tabelen 7 “Shpenzime të produkteve të programeve”;
 - Tabelen 8 “Projektet e Investimeve”;
 - Tabelen 9 “Të dhënat bazë mbi programet”;

- Relacion shpjegues për procesin e përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm (Shtojca 2, Programi Buxhetor Afatmesëm Vendor 2024-2026).
2. Ngarkohen ekzekutivi i bashkisë për zbatimin e këtij vendimi për vazhdimin e punës së mëtejshme të përgatitjes së PBA 2024-2026 sipas këtij dokumenti .

Konceptoi: S. Çepele

Konfirmoi: D.Hoxha

K R Y E T A R

Majlinda BUFI

Me mundësi eur dhe
Zv KRYETARI
Maksim GOGA

